



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Komisoni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjinore Mosdiskriminimit
dhe të Drejtave të Njeriut



Nr. 264/Prot

Fushë-Arrëz, më 28.01.2026

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr.2, datë 16/01/2026, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me Projekt vendimin "Mbi fondin e kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6% Dhjetor 2026"

Analiza ligjore: Në mbështetje të ligjit Nr. 57/2019, datë 18.07.2019. "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë" I ndryshuar, Kreu IV, pika 2 të Vendimit Nr.955, datë 07.12.2016, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike" të ndryshuar, Vendim Nr.5, datë 23.02.2018 "Mbi miratimin e kriterëve për familjet në nevojë, me përjashtim të pikës 1,6,7, që do të trajtohen me ndihmën ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të ndihmës ekonomike.

Situata aktuale e funksionit: Përmes fondeve të alokuara në këtë program buxhetor, synohet bashkia në harmoni me politikat kombëtare zhvillon programe për uljen e varfërisë. Në këtë drejtim bashkia ka punuar gjatë vitit në objektiva si: Buxheti i alokuar në këtë program buxhetor është përdorur nga bashkia për përmirësimin e shërbimeve që i ofrohen komunitetit për kujdesin social.

Situata financiare: Të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Dhjetor 2025, 28 familje, me fond 105,413 lekë nga fondi total i ndihmës ekonomike në vlerën 1,756,892 lekë dhe shpërndarë për përfituesit e 6% në Shumën 105,285 lekë.

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria e Çështjeve Sociale ka relatuar përpara komisionit për Projekt Vendimin

Monitorimi dhe raportimi : Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjinore Mosdiskriminimit dhe të Drejtave të Njeriut dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtoria e Çështjeve Sociale për zbatimin e projektit.

Impakti social / grupet që preken: Impakton jetën të gjitha shtresave të varfra në të gjithë territorin të bashkisë

A është objekt i konsultimit publik: Nuk është objekt konsultimi publik

Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjinore Mosdiskriminimit dhe të Drejtave të Njeriut, i mbledhur me datën 27/01/2026, shqyrtoi projekt vendimit nr.2, datë 16/01/2026, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me Projekt vendimin “Mbi fondin e kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6% Dhjetor 2026” paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T’i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Bashkëlidhur argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në relacionin e mbledhjes së Komisionit

Tereze Dem
(emri, mbiemri, firma)

Kryetar i Komisionit

Payton Gofa
(emri, mbiemri, firma)

Sekretar i Komisionit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

**Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjinore Mosdiskriminimit
dhe të Drejtave të Njeriut**



Nr. 259 prot.

Fushë-Arrëz, më 28.01.2026

PËR : KËSHILLIN E BASHKISË

FUSHË-ARRËZ

Lënda: Relacion mbi Projektvendimin “Për miratimin e listës së përfituesve të Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6% për muajin Dhjetor 2025”, që do t’i paraqitet Këshillit të Bashkisë për shqyrtim në mbledhjen e tij të datës 30.01.2026

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Per vetëqerisjen vendore”, i ndryshuar; Rregullores për Funksionimin e Këshillit të Bashkisë, Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjinore Mosdiskriminimit dhe të Drejtave të Njeriut, u mbledh sot, më 28.01.2026, ne sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak dhe mori në shqyrtim projektvendimin për miratimin e listës së përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6% për muajin Dhjetor 2025, paraqitur nga Sektori i Shërbimit Social.

Anëtarët e Komisionit janë njohur me projektin përmes materialit shkresor i cili gjendet edhe në faqen zyrtare web të Bashkisë Fushë-Arrëz, ndërkohë në mbledhjen e komisionit, shpjegimet i dha Znj. Klotilda Curri, Përgjegjëse në Sektorin e Çështjeve Sociale e cila shpjegoi se për muajin Dhjetor 2025 përfitojnë ndihme ekonomike nga fondi i bllok-ndihmës i 6%, 28 familje, me fond 105,413 lekë nga fondi total i ndihmës ekonomike në vlerën 1,756,892 lekë dhe shpërndarë për përfituesit e 6% në shumën 105,285 lekë sipas Njësive:

1. Bashkia Qendër Fushë-Arrëz , 15 familje me fond 46,499 lekë.
2. Njësia Administrative Qafë-Mali, 3 familje me fond 8,059 lekë .
3. Njësia Administrative Blerim, 3 familje me fond 14,313 lekë.
4. Njësia Administrative Fierzë, 3 familje me fond 19,424 lekë .
5. Njësia Administrative Iballë, 4 familje me fond 16,990 lekë .

Znj. Curri thekson se në Bashkinë Fushë-Arrëz, trajtohen me Ndihmë Ekonomike, mbi fondin e kushtëzuar për bllok-ndihmen ekonomike në masen 6%, familje të cilat janë të varfëra ku bazohemi edhe te VKB Nr.2, datë 27.01.2025 “Për miratimin e kritereve të përfitimit të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% për vitin 2025”. Qëllimi i trajtimit të këtyre familjeve me bllok-ndihmë 6% , është të ofrohet ndihmë për grupet në nevojë, të cilët nuk sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, si dhe zbutje të varfërisë.

Klotilda Curri, Përgjegjëse në Sektorin e Çeshtjeve Sociale, shpjegon se trajtohen me ndihmën ekonomike 6% të gjitha familjet që dalin nga sistemi për pikë të pamjaftueshme, Drande Bardhok Gjonaj, File Fran Lleshi, Gjeloş Pal Marku, Lize Prend Lleshi, Mine Sadri Kopani, Ndoc Kol Prendi, Spahe Besim Zmaka, Zef Preng Mejdani.

Largohet nga bllok-ndihma prej 6% familja: Ndrenica Preng Toma (Njësia Administrative Qafë-Mali)-Riaplikim në sistemin e Ndhmes Ekonomike.

Shtohen në bllok-ndihmën e 6% familjet:

1. Zef Preng Mejdani (Njësia Administrative Qafë-Mali).
2. Mine Sadri Kopani (Bashkia Qendër Fushë-Arrëz).
3. Ndoc Kol Prendi (Bashkia Qendër Fushë-Arrëz).

Franc Doda, anëtar i komisionit, i njohur edhe më parë me materialin, shprehet se është dakord me listën emrore të përfituesve të Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6% për muajin Dhjetor 2025.

Per muajin e ardhshem te rishikohet emri i Mine Kopani , mbase nuk eshte ne shkallen e nevojës lidhur me te ardhurat krahasuar me familje te tjera.

Ai thekson me force qe duhet te behen verifikimet e duhura per perfituesit e 6%- it, duhet te jene banore fizik ne bashkine tone. Ka persona qe kane shume kohe ne skemen e perfitimit dhe duhet te riaplikojne, kjo sipas kriterit nr.11 te miratuar me VKB 27.01.2025 “ Familjeve nje here ne tre muaj t’ju behet riaplikim ne skemen e ndihmes ekonomike.

Pavlin Qafa, anëtar i komisionit, shprehet se eshte dakord me propozimet e bera per familjet perfituese te ndihmes ekonomike nga fondi i bllok ndihmes prej 6 % , le te perfitojne te gjitha familjet qe plotesojne kritret e paracaktuara me VKB.

Franc Doda anëtar i komisionit, thekson ne menyre te perseritur se duhet te kontrollohen individet atje ku jetojne dhe si i kane kushtet ne menyre qe te trajtohen ato familje qe jane ne nevoje dhe qe plotesojne kriteret e perfitimit.

Tereze Dema, anetare e komisionit shprehet se eshte dakord me propozimet e bera per familjet perfituese te ndihmes ekonomike nga fondi i bllok ndihmes prej 6 %. Duhet te ndihmohen edhe familje te tjera ne nevoje per aplikim dhe te perfitojne sipas kriterëve te miratuara nga Keshilli Bashkiak. Anëtarët e komisionit kërkuar domosdoshmërisht zbatimin e kriterëve të perfitimit të 6%. Pas diskutimit anëtarët e komisionit, me shumicë votash, ranë dakort me projektin e paraqitur duke e derguar atë per miratim në mbledhjen e datës 30.01.2026

të Këshillit Bashkiak, duke kërkuar edhe mendime dhe propozime të tjera të këshilltarëve të pranishëm.

Duke kërkuar bashkepunimin tuaj!

KOMISIONI

Franc Doda



Tereze Dema



Pavlin Qafa

